



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1.4, të Ligjit nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 20, paragrafi 1 dhe paragrafi 3, pika 3.3 e Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, sipas Kërkesës së Kishës Ortodokse Serbe e fsh.Cërnice, pas Rekomandimit të Komitetit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, 01.Nr.164/2016 të datës 14.09.2016 si dhe pas Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me date 29.09.2016 miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës

I.

Kuvendi i Komunës së Gjilanit **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës lidhur me kërkesën e Kishës Ortodokse Serbe të fsh.Cërnice, për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës për nevoja të ndërtimit të objektit përcjellës kishtar për zhvillimin e ritualeve të varrimit të komunitetit ortodoks në këtë fshat të Komunës së Gjilanit.**

II.

Lejohet shfrytëzimi i sipërfaqes prej 600 m² sipas paraqitjes grafike duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal, nga njësia kadastrale :

- P-70403062-02216-0, te vendi i quajtur “Cërnice”, lloji i njësisë- parcelë, lloji i pronës- pronë shoqërore, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës 2197m² , shfrytëzimi aktual i parcelës – rajon ujqor – hendek , e cila evidentohet në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjilan.

III.

Sipërfaqja prej 600 m² ipet në shfrytëzim pa kompensim dhe ka dedikimin për nevoja të ndërtimit të objektit përcjellës kishtar i cili do të shfrytëzohet nga ana e komunitetit fetar ortodoks .

IV.

Afati i shfrytëzimit të kësaj sipërfaqe është 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

V.

Obligohet shfrytëzuesi i kësaj hapsire që të njejtën ta shfrytëzon dhe ta mirëmbajë si nikoqir i mirë me dedikimin për nevoja të zhvillimit të aktiviteteve fetare.

VI

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta bënë parcelimin e sipërfaqes të dedikuara për objekt ndihmës në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal dhe njësinë e re kadastrale të krijuar pas parcelimit ta evidenton në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim Kishës Ortodokse Serbe në fshatin Cërnice .

VII

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

VIII.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 016-98705
Gjilan, më 29.09.2016

Kryesuesja e Kuvendit,

/Valentina Bunjaku –Rexhepi/